



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 152 – Korrik – 2016 – Zyra për Informim Publik - <https://kk.rks-gov.net/malisheve/>



Pamje gjatë garave memoriale “Esmir Shala” në Banjë



Përmbajtja:

Gjermani Rudolf Broer ndihmon QKMF-në dhe Handikos-in në Malishevë.....	3
74.6 përqind e maturanëve malishevas, e kanë kaluar testin e maturës	3
Kryetari Begaj, priti kolonelin italian Giagheddu	5
Volejbollistet e Pagarushës u pritën nga kryetari i komunës	6
Kryetari Begaj, priti shkencëtarin e ri, Arsim Bytyqi	6
Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt.....	7
Ka filluar ndërtimi i nënkalimit në Dragobil	8
Filloi hapja e kanalit për shkarkimin e ujërave atmosferik në Banjë	9
Komiteti për Komunitete dha tri rekomandime për Kuvendin e Komunës.....	10
Kryetari Begaj shpallet i pafajshëm.....	10
Kuvendi i Komunës së Malishevës, shqyrtoi raportin e auditorit për vitin 2015.....	11
1008 nxënës janë regjistruar në shkollat e mesme	12
Vazhdon realizimi i disa projekteve në Komunën e Malishevës.....	12
Begaj falënderoi humanistin gjerman Manfred Wittwer	13
Nderohen dëshmorët nga Malisheva, të rënë në betejën e Rahovecit.....	14
Bashkim Ferat Shala, dhuroi 51 karroca për personat me nevoja të veçanta	15
Tregu i kafshëve vazhdon të mbetet i mbyllur, respektohet urdhëresa e AVUK-ut.....	15
KN “Besa”, kampion i Kosovës për junior	16
Filloi rehabilitimi i ujësjellësit në Astrazup	17
Të hënën e ardhshme fillon festivali “Oda e Llapushës”	18
Të gjitha rrugicat e Bardhit do të shtrohen me kubëza	19
MKRS dhe Komuna, nënshkruajnë marrëveshje për rregullimin e stadiumit	19
Klubet e notit “Besa” dhe “Zenit” fitues të garës memoriale “Esmir Shala”	20
Filloi renovimi i ankesit të shkollës së Mirushës.....	22
27 shkolla të Malishevës marrin donacion nga USAID-i	23



Gjermani Rudolf Broer ndihmon QKMF-në dhe Handikos-in në Malishevë

Malishevë, 1 korrik



Biznesmeni dhe humanisti gjerman Rudolf Broer, sot ka ndihmuar Komunën e Malishevës, përkatësisht Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë dhe Qendrën e Rehabilitimit HANDIKOS në Malishevë, me një veturë (kombibus) për bartjen e personave në hemodializë dhe tetë karroca për persona me nevoja të veçanta. Me këtë rast, humanistin gjerman, e ka falënderuar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Deri tek ky donacion, ka ardhur pas kontakteve dhe bashkëpunimit mes kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe humanistit gjerman Rudolf Broer, gjatë vizitës së kryetarit Begaj në Gjermani dhe vizitës së para pak kohe të Broerit në Malishevë, ku ky i fundit kishte premtuar këtë ndihmë.

Pas kryerjes së të gjitha procedurave, ky humanist, sot e ka sjellë në Malishevë këtë automjet, në shërbim të QKMF-së, përkatësisht bartjes së personave në hemodializë, si dhe ka sjellë edhe tetë karroca për personat me aftësi të kufizuara, të cilat ja ka dorëzuar Qendrës së Rehabilitimit HANDIKOS në Malishevë.

Kryetari i Komunës së Malishevës, për këtë donacion e ka falënderuar humanistin Broer.

74.6 përqind e maturanëve malishevas, e kanë kaluar testin e maturës

Malishevë, 6 korrik



Rezultatet e maturantëve malishevas, në testin shtetëror të maturës, kanë qenë të mira, pasi 74.6 përqind të maturantëve, e kanë kaluar me sukses testin. Kështu ka konfirmuar drejtori komunal për arsim, Avdi Morina, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve. Po ashtu në këtë mbledhje u bë e ditur se kanë filluar përgatitjet për festivalin “Oda e Llapushës”.

Në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për punën dhe aktivitetet e tyre, para kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Sipas drejtorit të arsimit, Avdi Morina, rezultati i maturantëve ka qenë i mirë, pasi shumica e maturantëve, suksesshëm e kanë kaluar testin e maturës. Në këtë mbledhje, drejtori Morina, në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor, tha se duhet disa ndërhyrje në disa shkolla, sidomos në kulme, pasi kanë dëmtime dhe duhet të rregullohen, para fillimit të vitit shkollor.

E kur jemi tek shkollat, gjatë paraqitjes së aktiviteteve të zyrës së prokurimit, udhëheqësi i këtij sektori, Ekrem Kastrati, ka bërë të ditur se kanë përfunduar të gjitha procedurat për ndërtimin e shkollës në Berishë, dhe menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, do të fillohet me ndërtimin e objektit të ri shkollor.

Në këtë mbledhje, drejtoresha për kulturë, Blerita Kransiqi, ka njoftuar se janë duke u bërë përgatitjet për mbajtjen e festivalit tradicional “Oda e Llapushës”.

Sa i përket gjendjes epidemiologjike, drejtori për shëndetësi Hajdin Berisha, ka bërë të ditur, se kjo situatë është e qetë, ndërsa numri i thumbimeve ka filluar të shënoj rënie, çdo ditë e më tepër.

Kurse drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, ka njoftuar se janë duke u realizuar disa projekte me rëndësi, në disa vendbanime të Komunës së Malishevës, si rrugë, kanalizime, rrethoja të oborreve të shkollave, në Malishevë, Balincë, Gurishtë, dhe vende tjera, ndërsa në procedurë janë edhe disa projekte që shpejt do të fillohet me realizimin e tyre.

Edhe drejtori për mbrojtje dhe shpëtim, Sejdi Paçarizi, tha se gjatë javës së kaluar, nuk ka pasur incidente të zjarreve dhe situata e sigurisë ka qenë në nivel.

Kurse shërbimet publike dhe inspektorati, kanë raportuar për disa probleme me rrjetet e kanalizimeve, por edhe me probleme me ujë pije. Sipas drejtorit të shërbimeve publike, Milazim Morina, kanë filluar të shtohen kërkesat për ujë për pije dhe ankesat për probleme me gypin kryesor të kanalizimit, sidomos në pjesë mes Damanekut dhe Bublrit.

Përgatitjet për korrje shirje, janë pothuajse në përfundim dhe shtabi komunal, është duke u marrë me këtë fushatë, tha drejtori i bujqësisë Haxhi Krasniqi, sipas të cilit vende vende edhe kanë filluar me korrjen e grurit.



Edhe shërbimet komunale, përkatësisht pajisja me dokumente për qytetarët, po ecën mirë dhe nuk kemi vonesa në kryerjen e këtyre shërbimeve. Drejtori i administratës, Hajrullah Mazreku, ka bërë të ditur se drejtoria i ka marrë të gjitha masat për ofrimin shërbimeve sa më të shpejta për të gjithë qytetarët, e në veçanti për mërgimtarët. “Nëse paraqitet nevoja, ne do të punojmë edhe jashtë orarit, në mënyrë që të gjithë qytetarët ti marrin shërbimet që kanë nevojë”, tha drejtori Mazreku.

Kryetari Begaj, priti kolonelin italian Giagheddu

Malishevë, 6 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim, komandantin e grupit luftarak shumëkombësh perëndim (MNBG-W), kolonelin Giovani Giagheddu. Ky takim kishte karakter njoftues, mes kolonelit italian dhe kryetarit të Malishevës. Kryetari Begaj, e ka falënderuar për vizitën, si dhe e ka njoftuar me situatën e përgjithshme në Malishevë.



Kryetari Begaj, e ka njoftuar kolonelin Giagheddu, për situatën e përgjithshme në Malishevë, zhvillimin ekonomik, social, infrastrukturën në Komunën e Malishevës, si atë rrugore, ashtu edhe atë shkollore, numrin popullsisë dhe të nxënësve. Ndërsa në aspektin e sigurisë, kryetari Begaj, e njoftoi komandantin italian, se Malisheva, është njëra prej komunave më të sigurta në vend, në aspektin e sigurisë së përgjithshme.

Kryetari Begaj, edhe në këtë rast e ka falënderuar KFOR-in në përgjithësi, dhe në veçanti kontingjentin italian, për mbështetjen e dhënë për Kosovën dhe për Malishevën, në rindërtimin e pasluftës dhe për bashkëpunimin e mirë, mes Komunës së Malishevës dhe KFOR-it.



Begaj e Giagheddu, thanë se ky bashkëpunim do të vazhdoj edhe në të ardhmen.

Volejbollistet e Pagarushës u pritën nga kryetari i komunës

Malishevë, 8 korrik

Klubi i volejbollit për femra, të ShFMU “Vesel Pagarusha” nga Pagarusha, janë pritur sot nga Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Avdi Morina dhe drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi. Qëllimi i kësaj pritje, ishte sukcesi i klubit të volejbollit të kësaj shkolle, që kanë treguar gjatë këtij viti në garat shkollore.

Kryetari Begaj dhe drejtoresha Krasniqi, e kanë përgëzuar klubin e volejbollit nga Pagarusha, për sukseset që kanë treguar gjatë këtij viti, si në garat komunale, regjionale dhe nacionale, që janë mbajtur gjatë këtij viti.

“Unë ju përgëzoj për këtë sukses dhe ju falënderoj për përfaqësimin e mirë që i keni bërë Komunës së Malishevës”, tha kryetari Begaj, i cili ju premtoi mbështetje në organizimet e tilla, por kërkoi nga nxënëset, që në rend të parë të jenë nxënëse të mira në mësim.

Drejtori dhe mësuesit e kësaj shkolle, e kanë falënderuar kryetarin dhe drejtoritë komunale, për pritjen dhe për mbështetjen e dhënë gjatë zhvillimit të garave.

Përndryshe, klubi i volejbollit të ShFMU “Vesel Pagarusha”, e ka zënë vendin e parë në garat komunale, vendin e parë në garat regjionale dhe vendin e dytë në nivel vendi, ndërsa të gjitha këto aktivitete janë zhvilluar me mbështetjen e drejtorive për Arsim dhe Edukim dhe asaj për Kulturë, Rini dhe Sport.

Kryetari Begaj, priti shkencëtarin e ri, Arsim Bytyqi

Malishevë, 11 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur sot, Dr.Arsim Bytyqin shkencëtar i ri, i cili është prej tre fituesve të garës ndërkombëtare “**Helium Innovation Contest**”, e mbajtur në New York të SHBA-ve. Qëllimi i kësaj pritje ishte, dhënia e një mirënjohjeje për vlerat e



prezantuara nga Bytyqi, në këtë garë dhe pjesëmarrja e një malishevasi në një ngjarje të tillë shkencore.



“Unë ju përgëzoj juve për paraqitjen dhe suksesin e treguar në këtë garë, por edhe fushën studimore në përgjithësi, si një shkencëtar i ri dhe një doktor shkence, në fushën biokimisë dhe nanoteknologjisë”, i tha kryetari Begaj. “Çdo malishevas që merr pjesë një këso ngjarje shkencore dhe prezantohet me të arriturat në shkencë, është krenari për neve të gjithë”, ka thënë kryetari Begaj, në pritjen për Dr.Arsim Bytyqin.

Nga ana tjetër, Bytyqi, e ka falënderuar kryetarin Begaj dhe Komunën e Malishevës, për këtë pritje dhe për vlerësimin që në vazhdimësi ju ka bërë të gjithë malishevasve, të cilët kanë treguar rezultate të ndryshme në fushat e caktuara. “Ky vlerësim më bën të punoj edhe më shumë”, tha Dr.Arsim Bytyqi.

Dr.Arsim Bytyqi, është nga Kërvasaria e Komunës së Malishevës, dhe është prej shkencëtarëve të rinj, që po arrin rezultate të mira në fushën biokimisë dhe nanoteknologjisë.

Këshilli i Drejtorëve, mbajti mbledhjen e rregullt

Malishevë, 11 korrik

Këshilli i Drejtorëve të Komunës së Malishevës, nën drejtimin e nënkryetarit të komunës, Rexhep Mazreku, ka mbajtur sot mbledhjen e rregullt të së hënës, ku drejtorët e drejtorive, kanë raportuar për punën dhe aktivitetet e drejtorive, gjatë javës së kaluar dhe për aktivitetet e planifikuara për këtë javë.

Në këtë mbledhje të radhës, bazuar në raportimet e drejtorive, u tha se janë duke vazhduar me realizimin e shumë projekteve, pothuajse në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës,



ndërsa u raportua se edhe fushata e korrje shirjeve po vazhdon normalisht dhe pa probleme, ndërsa po monitorohet nga shtabi komunal i formuar për përcjelljen e korrje shirjeve në Komunën e Malishevës.

Ndërsa situata epidemiologjike me EHKK, u raportua e qetë deri më tani, pa raste të infeksioneve me EHKK, ndërsa prej sot ka filluar të realizohet edhe faza e katërt e repelimit të kafshëve, si masë parandaluese, për bartjen e rriqrave nga fusha dhe mali.

Ka filluar ndërtimi i nënkalimit në Dragobil

Malishevë, 12 korrik



mësojnë në këtë shkollë.

Në kuadër të përpjekjeve për rregullimin e infrastrukturës së përgjithshme në territorin e Komunës së Malishevës dhe krijimit të kushteve më të mira për të gjithë qytetarët, në veçanti për nxënësit, këto ditë ka filluar ndërtimi i nënkalimit në Dragobil, me qëllim të qarkullimit të sigurt të nxënësve për në shkollën e fshatit. Ky nënkalim, mundëson kalimin e rrugës magjistrale, që deri më tani ka qenë rrezik për nxënësit e tri fshatrave që

Fillimin dhe ecurinë e punimeve në ndërtimin e nënkalimit, e ka përcjellë edhe drejtori i urbanizimit në Komunën e Malishevës, Ahmet Morina, i cili tha se “ndërtimi i këtij nënkalimi pritet të përfundoj brenda muajit dhe punimet do të bëhen sipas standardeve”. Drejtori Morina, e quajti “shumë të rëndësishëm realizimin e këtij projekti, pasi aktualisht, nxënësit e kësaj shkolle, kanë qenë më të rrezikuarit, për shkak të kalimit të rrugës magjistrale Prishtinë-Malishevë-Rahovec, e që në ta kaluarën ka pasur edhe aksidente”.

“Më herët është ndërtuar trotuari për një pjesë të nxënësve, ndërsa tani po rregullojmë edhe nënkalimin dhe shumë shpejt pritet edhe ndërtimi i trotuarit në pjesën e poshtme të rrugës, në mënyrë që nxënësit që vijnë nga katër drejtimet, të mos rrezikohen duke ecur përgjatë rrugës, por të shfrytëzojnë nënkalimin dhe trotuarin”, tha drejtori Morina.

Përndryshe, në shkollën e fshatit Dragobil mësojnë nxënës nga fshatrat Dragobil, Maxharrë dhe një pjesë e Astrazupit, ndërsa shumica e nxënësve kanë qenë të detyruar ta kalojnë rrugën magjistrale, pasi shkolla gjendet jashtë fshatit dhe në anën tjetër të rrugës magjistrale.



Ndërtimin e nënkalimit e ka mirëpritur banorët e këtyre fshatrave, e sidomos prindërit, pasi fëmijët çdo ditë shkolle, kanë qenë të rrezikuar, dhe nënkalimi që po ndërtohet, krijon siguri më të madhe për prindërit, të cilët, në vazhdimësi kanë qenë të detyruar ti përcjellin fëmijët në shkollë, sidomos ata të klasave të ulëta, pikërisht për shkak të kësaj rruge.

Sipas drejtorit Morina, nënkalimi pritet të përfundoj brenda muajit, ndërsa shuma e projektit është rreth 64 mijë euro.

Filloi hapja e kanalit për shkarkimin e ujërave atmosferik në Banjë

Malishevë, 13 korrik



Në fillim të këtij viti, Komuna e Malishevës është përballur me reshje të mëdha dhe rrjedhimisht me përmytje dhe vërshime, si dhe me dëme të konsiderueshme. Po ashtu, gjatë shirave, disa nga rrugët janë bllokuar për qarkullim, si pasojë e bllokimit të kanaleve shkarkuese të ujërave atmosferik. Një prej rrugëve që vazhdimisht bllokohet nga uji, është rruga Malishevë-Banjë, që lidhet me rrugën e kombit dhe Suharekën.

Për të mos pasur më probleme në këtë rrugë, Komuna e Malishevës, ka filluar me hapjen e kanalit, i cili do ta shkarkon ujin nga kjo rrugë.

Kanali po hapet, në afërsi të pishinave të Banjës, ku edhe grumbullohet uji në sasi të mëdha. Në këtë vend, po bëhet hapja e kanalit nën rrugë dhe kanaleve apo uJORëve që e shkarkojnë ujin mbi dhe nën rrugë, në drejtim të lumit.

Sipas drejtorit të urbanizmit, Ahmet Morina, ky projekt i cili financohet nga komuna, kushton afër shtatë mijë euro dhe pritet të përfundoj brenda një jave. Ndërsa drejtoria, i ka marrë të gjitha masat për realizimin e këtij projekti, duke mos e penguar qarkullimin në këtë rrugë.



Komiteti për Komunitete dha tri rekomandime për Kuvendin e Komunës

Malishevë, 14 korrik

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendi të Komunës së Malishevës, nën drejtimin e kryesuesit të këtij komiteti, Labinot Gashi, ka mbajtur mbledhjen e rregull. Në këtë mbledhje, u shqyrtua raporti i punës së Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, ndërsa në fund, komiteti ka dhënë edhe tri rekomandime, që do të bëhen Kuvendit të Komunës, për planifikimin buxhetor.

Fillimisht drejtori i arsimit, Avdi Morina, raporti për punën e kësaj drejtorie në gjashtë mujorin e parë, si dhe për procesin e regjistrimit të nxënësve në vitin e ri shkollor. Sipas drejtorit, është përmbyllur një vit i suksesshëm, sidomos në infrastrukturën shkollore, por edhe në suksese në mësim, suksese të cilat vet nxënësit, i kanë arritur në garat e ndryshme shkollore. Po ashtu, edhe testi i maturës ka qenë shumë i suksesshëm, ku maturantët tanë kanë treguar rezultat të mirë, sikur që edhe testi i arritshmërisë ka dalë me rezultat të mirë. Sa i përket regjistrimit, drejtori Morina tha se janë duke u regjistruar nxënësit në shkollën e mesme, në gjimnaz dhe dy shkollat profesionale.

Anëtarët e komitetit, duke e shqyrtuar këtë raport, kërkuan nga drejtorja, që të mos lejoj mbingarkesë në klasa, pasi hapësira është e mjaftueshme.

Në fund, komiteti miratoi edhe tri rekomandime për Kuvendin e Komunës. Rekomandimi i parë është që të ndahen mjete për përfundimin e kanalizimit në Kijevë, ndërsa rekomandimi i dytë ishte për ndarjen mjeteve për vendosjen e shenjave në rrugë, sidomos në vendet e frekuentuara, siç janë shkollat dhe rekomandimi i tretë, ishte për ndarjen e mjeteve për zgjidhjen e çështjes së banimit, për dy familje të komunitetit RAE.

Kryetari Begaj shpallet i pafajshëm

Malishevë, 14 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, është shpallur i pafajshëm në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale, për “shpërdorim detyre”. Gjykata në Gjakovë, e ka shpallur të pafajshëm Begajn dhe këtë e konfirmuar avokati mbrojtës i kryetarit Begaj, Emrush Kastrati, menjëherë pas përfundimit të gjyqimit.



Sipas avokatit Kastrati, prokurori i Prokurorisë Speciale, Haki Gecaj, kishte ngritur aktakuzën dhe kishte kërkuar dënimin e kryetarit Begaj, mirëpo faktet dhe provat e ofruara nga ana e prokurorisë, lidhur me rastin e ish drejtorit të ShFMU “Ganimete Tërbeshi” ishin të pabaza dhe gjykata sot mori vendimin e drejtë, duke e shpallur të pafajshëm kryetarin e Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Vlen të theksohet, se Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ishte shumë bashkëpunues me organet e drejtësisë gjatë tërë procesit, nga fillimi e deri më tani, kur edhe është shpallur i pafajshëm lidhur me akuzën për shpërdorim të detyrës zyrtare.

Kuvendi i Komunës së Malishevës, shqyrtoi raportin e auditorit për vitin 2015

Malishevë, 15 korrik



Kuvendi i Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi Aziz Thaçi ka mbajtur sot mbledhjen e shtatë të rregullt për këtë vit. Mbledhja e sotme, ka filluar me një minutë heshtje në për viktimat e mbrëmshme në Nice të Francës, ku humbën jetën mbi 80 qytetarë. Temë kryesore e mbledhjes së sotme, ishte shqyrtimi i raportit të auditorit të përgjithshëm për vitin 2015.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës, gjatë shqyrtimit të këtij raporti, megjithëse thanë se llogaritet si raporti më i mirë deri më tani dhe ndoshta raporti më i mirë nga të gjitha komunat e vendit, thanë se rekomandimet e dhëna nga ana e auditorit, duhet të realizohen.

Anëtarët kërkuan sqarime për disa nga rekomandimet e auditorit, ndërsa për të gjitha këto pyetje, sqarimet para anëtarëve të kuvendit, i kanë dhënë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe zyrtares kryesore financiare, Halil Shurdhaj.

Në mbledhjen e sotme, Kuvendi i Komunës së Malishevës, ka miratuar edhe dy kërkesa të qytetarëve, për ndërrim destinim të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore.



1008 nxënës janë regjistruar në shkollat e mesme

Malishevë, 18 korrik

Sot në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të mbajtur nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, gjatë raportimit të tij, drejtori për arsim dhe edukim, Avdi Morina, tha se në afatin e parë të regjistrimit në shkollat e mesme, janë regjistruar 1008 nxënës, në të tri shkollat e mesme të Komunës së Malishevës.

“Në gjimnaz dhe në dy shkollat profesionale, janë regjistruar 1008 nxënës, në afatin e parë, ndërsa në afatin e dytë, pritet të regjistrohen edhe mbi 300 nxënës të tjerë”, tha drejtori Morina, ai gjithashtu, tha se nuk do të lejohet që të rritet numri i nxënësve nëpër klasa, pasi hapësira ekziston, si dhe kanë mundësi të zgjedhin drejtimet.

Përndryshe, gjatë raportimeve të drejtorëve, u tha se fushata e korrje shirjeve është drejt përfundimit dhe nuk janë regjistruar probleme, përjashtuar djegien e një autokombajne. E djegia e kësaj autokombajne ka qene edhe aksidenti i vetëm i regjistruar gjatë javës së kaluar, ku sipas drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, flakët kanë djegur edhe rreth 15 ari me grurë.

Sa përket situatës epidemiologjike me EHKK, u tha se është e qetë dhe nuk ka raste të infektimit, mirëpo me paraqitjen e rasteve në komunat tjera, neve si institucione, na bën të jemi të kujdesshëm edhe më shumë.

Po ashtu, drejtorja për kulturë, bëri të ditur se duke vazhduar përgatitjet për mbajtjen e festivalit folklorik “Oda e Llapushës” me 1 dhe 2 gusht.

Vazhdon realizimi i disa projekteve në Komunën e Malishevës

Malishevë, 19 korrik

Komuna e Malishevës, është duke vazhduar me realizimin e disa projekteve, në tërë territorin e saj. Kështu u tha gjatë raportimit të drejtorit të drejtorisë së urbanizimit Ahmet Morina, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve. Aktualisht, në Komunën e Malishevës, janë duke u ndërtuar shkolla, rrugë, kanalizime dhe shumë projekte tjera, që janë në shërbim të qytetarëve.



Sipas drejtorit të Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, aktualisht po shtrohen me kubëza dy rrugë, një në Malishevë dhe një në fshatin Gurishtë. Rruga në fshatin Gurishtë, e lidhë shkollën e fshatit me rrugën kryesore. Po ashtu në Gurishtë, është ndërtuar edhe një pjesë e kanalizimit. Po ashtu po vazhdohet me punimin e nënkalimit në Dragobil, si dhe ka filluar riparimi i kanalizimeve që kanë probleme. “Këto ditë, pritet të filloj ndërtimi i rrugëve edhe në fshatin Bardh, si dhe vendosja e tabelave me emrat e rrugëve në tërë territorin e Komunës së Malishevës”, tha drejtori Morina.

Disa nga këto projekte që janë duke u realizuar, gjatë këtij vikendi i ka vizituar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Qëllimi i këtyre vizitave në Malishevë dhe Gurishtë, ka qenë ecuria e implementimit të këtyre projekteve, si dhe bisedat me banorët vendës, të cilët i ka uruar për këto projekte.

“Uroj që këto projekte, të realizohen sa më shpejt që është e mundur dhe të jenë në shërbim të qytetarëve, pasi edhe qëllim i yni është rritja e mirëqenies së qytetarëve, përmes investimeve konkrete që ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve të Komunës së Malishevës”, tha kryetari Begaj.

Drejtori Morina, ka bërë të ditur se projekte në realizim e sipër dhe projekte që do të fillojnë gjatë kësaj jave, ose javës tjetër, janë të shumta dhe kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturën në përgjithësi.

Begaj falënderoi humanistin gjerman Manfred Wittwer

Malishevë, 19 korrik

Kryetari i Komunës së Malishevës, ka pritur sot në një takim, humanistin e njohur gjerman, nga qyteti i Soestit, Manfred Wittwer, të cilin e ka falënderuar për angazhimin e tij, në sigurimin e dy kontingjenteve me inventar, për shkollat e Komunës së Malishevës. Po ashtu, kryetari Begaj, krahas humanistit Wittwer, ka falënderuar edhe bashkatdhetarin Nuhi Krasniqi, i cili gjithashtu



ka kontribuar në sigurimin e këtyre donacioneve, por edhe në krijimin e lidhjeve të bashkëpunimit me qytetin Soest në Gjermani.

“Ne ju jemi shumë mirënjohës për ndihmën e dhënë dhe për pritjen që na



keni bërë në Soest. Dëshiroj që bashkëpunimi mes qytetit të Soestit dhe Malishevës, të vazhdoj edhe në fushat e tjera”, tha kryetari Begaj, me rastin e takimit me Manfred Wittwer.

Edhe humanisti Wittwer, e falënderoi Komunën e Malishevës dhe kryetarin Begaj, për pritjen dhe tha se do të jetë i angazhuar në thellimin e bashkëpunimit me Malishevën.

Falë angazhimit të këtij humanisti gjerman dhe bashkatdhetarit Nuhi Krasniqi, qyteti i Soestit ka dhënë donacion për shkollat e Malishevës, inventar për shkolla, ndërsa kjo formë e donacionit, pritet të rritet edhe në vitin tjetër, sikur që pritet të rritet edhe bashkëpunimi mes qytetit të Soestit dhe Malishevës.

Në këtë pjesë të Gjermanisë, jetojnë dhe punojnë shumë bashkatdhetar nga Kosova, dhe nga Malisheva në veçanti, ndërsa gëzojnë respekt nga ana e qytetarëve dhe autoriteteve të Soestit dhe vendeve përreth.

Nderohen dëshmorët nga Malisheva, të rënë në betejën e Rahovecit

Malishevë, 19 korrik



Sot, me nderime pranë varrezave të dëshmorëve dhe në vendin e rënies, janë nderuar dëshmorët e kombit, nga Komuna e Malishevës të rënë në korrik të vitit 1998, në betejën e Rahovecit. Homazhe dhe nderime kanë bërë, familjarë të dëshmorëve, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj me bashkëpunëtor, bashkëluftëtarë dhe qytetar të tjerë.

“Të jeni të fortë dhe krenarë për bijtë, baballarët dhe familjarët e juaj, që i dhatë tokës së Kosovës, për lirinë e vendit. Gjaku dhe sakrifica e tyre, na sollën neve lirinë, që ne sot të jetojmë të lirë”, tha mes tjerash kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, gjatë homazheve.

Komuna e Malishevës, ka dhënë tetë dëshmorë gjatë atyre ditëve të korrikut të vitit 1998, në Betejën e Rahovecit. Në këtë betejë, kanë rënë: Gani Paçarizi, prof.Hamdi Berisha, Sadik Shala, Liman Gegaj, Afrim Krasniqi, Habib Berisha, Ramadan Morina dhe Ruzhdi Gjyliqi.



Bashkim Ferat Shala, dhuroi 51 karroca për personat me nevoja të veçanta

Malishevë, 19 korrik



Mërgimtari Bashkim Ferat Shala, nga fshati Guncat i Komunës së Malishevës, që jeton dhe punon në Zvicër, ka dhënë një donacion domethënës për personat me nevoja të veçanta, nga Komuna e Malishevës. Ai sot, ja ka dhuruar organizatës për personat me nevoja të veçanta “Handikos” në Malishevë, 51 karroca.

Këtë donacion, e ka konfirmuar koordinatojta e Qendrës së Rehabilitimit “Handikos” në Malishevës, Feride Hoxha, e cila e falënderon mërgimtarin Bashkim Shala, për këtë donacion shumë domethënës, për personat me nevoja të veçanta. “Këta persona, për të parë dritën e diellit, ju duhet të lëvizin, të dalin jashtë mureve të shtëpisë dhe shumë prej këtyre personave, sot po ju mundëson ky mërgimtar, i cili i ka blerë dhe sot po ju dhuron karrocet, atyre që kanë më së shumti nevojë”, tha koordinatojta Hoxha.

Këtë donacion të mërgimtarit Bashkim Ferat Shala, e ka përshëndetur dhe falënderuar edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, pasi është një prej atyre donacioneve më humane të mundshme.

Tregu i kafshëve vazhdon të mbetet i mbyllur, respektohet urdhëresa e AVUK-ut

Malishevë, 21 korrik

Sot në Malishevë është ditë tregu, mirëpo tregu i kafshëve vazhdon të mbetet i mbyllur, pasi javë më parë Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit e Kosovës (AVUK), ka urdhëruar mbylljen e



tregut të kafshëve, për shkak të parandalimit të sëmundjes gungore tek kafshët. Këtë urdhëresë po e respektojnë në përpikëri në Malishevë, deklaruan inspektorët komunal.

Sipas shefit të inspektorëve në Komunën e Malishevës, Bardhyl Buçaj, “tregu i kafshëve, vazhdon të mbetet i mbyllur, pasi AVUK-u, nuk ka lëshuar ndonjë urdhëresë tjetër, mirëpo edhe vet tregtarët, por edhe qytetarët po e zbatojnë këtë urdhëresë dhe deri më tani, inspektorët komunal nuk kanë hasur në shkelje të kësaj urdhërese”.

“Ne i falënderojmë të gjithë qytetarët (blerësit), tregtarët me kafshë dhe pronarin e tregut të kafshëve për zbatimin e kësaj urdhërese”, tha shefi i inspektorëve Bardhyl Buçaj. Ai po ashtu bëri të ditur se inspektorët, gjithashtu në vazhdimësi janë duke i kryer kontrollet e tyre në terren, por për shkak të vetëdijesimit të lartë të qytetarëve, deri më tani nuk ka pasur asnjë rast të shkeljes së kësaj urdhërese.

KN “Besa”, kampion i Kosovës për junior

Malishevë, 22 korrik

Sot ka përfunduar kampionati i Kosovës në not. Klubi i notit “Besa” nga Banja, ka treguar rezultatet më të mira në konkurrencën e juniorëve dhe vazhdon të jetë klubi më i mirë në vend dhe të mbetet kampion, sikur që ka qenë gjithmonë. Kampionati i Kosovës në not, është mbajtur në pishinat në Zllakuqan.



Klubi i notit “Besa”, nën drejtimin e trajnerit Ardian Telaku, ka marrë pjesë vetëm në konkurrencën e juniorëve dhe në bazë të pikëve të përgjithshme, zuri vendin e parë, ashtu sikur në shumë disiplina që kanë zënë vendin e parë, përfshi edhe stafetën.

“Me gjithë kohën e shkurtë të përgatitjeve që kemi pasur, pasi ne nuk kemi pishina të



mbyllura, rezultatet e treguara nga notarët e KN “Besa”, ishin të mira dhe arritëm të jemi përsëri kampion në këtë kategori”, tha Ardian Telaku, trajner i klubit.

Përndryshe, klubi i notit “Besa”, vazhdon të mbetet krenaria e Komunës së Malishevës, në sport.

Filloi rehabilitimi i ujësjellësit në Astrazup

Malishevë, 25 korrik

Sot në Astrazup, kanë filluar punimet në rehabilitimin e ujësjellësit. Ky projekt që filloi sot të



realizohet është në kuadër të projektit të gjerë për rehabilitimin e ujësjellësve në njëmbëdhjetë vendbanime të Komunës së Malishevës. Projekti realizohet krahas projektit tjetër të ujësjellësit të ri për rreth 13 fshatra. Këto dy projekte të mëdha, financohen dhe implementohen nga qeveria zvicerane, si donator kryesor, njësia e Hidroregjionit jugor dhe Komuna e Malishevës.

Rehabilitimi i ujësjellësit që filloi sot në Astrazup, është me rëndësi jetike për banorët e këtij fshati të madh në Komunën e Malishevës, pasi kanë mungesë të theksuar të ujit për pije, kurse ujësjellësi i ndërtuar më herët, është tërësisht jashtë funksionit, por nga sot, banorët e Astrazupit, janë të sigurt që brenda pak kohe do të kenë ujë të mjaftueshëm për pije, sepse me rehabilitimin e gypave të ujësjellësit dhe rehabilitimin e rezervuarit, problemi i furnizimit me ujë do të zgjidhet përfundimisht.

Me rastin e fillimit të punimeve në rehabilitimin e ujësjellësit në Astrazup, morën pjesë Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, përgjegjësi i njësisë së Hidroregjionit jugor në Malishevë, Njazi Bytyçi, të cilët i kanë uruar banorët për realizimin e këtij projekti.

“Sigurimi i ujit për pije, është diçka elementare dhe jetike për banorët e Astrazupit dhe unë sot ju përgëzoj të gjithëve, pasi arritëm të sigurojmë këtë projekt, i cili do të zgjidh përfundimisht problemin jetik për juve”, tha mes tjerash kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj.

Punëkryes i këtij projekti është kompania “Muratori”.



Të hënën e ardhshme fillon festivali “Oda e Llapushës”

Malishevë, 25 korrik

Si çdo të hënë, edhe sot është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive, raportuan për aktivitetet e tyre gjatë javës. Në këtë mbledhje u bë e ditur se janë duke u realizuar disa projekte, kurse lajm me rëndësi ishte njoftimi për mbajtjen e garës memoriale në not “Esmir Shala” dhe fillimi i festivalit tradicional folklorik “Oda e Llapushës”.

Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Blerta Krasniqi, bëri me dije, se janë duek u marrë me përgatitjet për dy ngjarje me rëndësi, e para gara tradicionale e notit “Esmir Shala”, që është garë memoriale, në kujtim të ish reprezentuesit të Kosovës në not, Esmir Shala, që mbahet me 28 korrik, si dhe përgatitjet për mbajtjen e festivalit tradicional të folklorit “Oda e Llapushës” që mbahet me 1 dhe 2 gusht, në kuadër të shënimit të ditëve të mërgatës. S ai përket sportit, drejtoresha Krasniqi, po ashtu njoftoi se është formuar dhe regjistruar klubi i futbollit të madh dhe pritet që në vjeshtë të filloi me zhvillimin e garave.

Sa i përket investimeve kapitale, drejtori i urbanizimit Ahmet Morina, bëri të ditur, se janë duke u realizuar disa projekte, si rrugët në Maxharrë, Pagarushë e Bardh, pastaj renovimet e kanalizimeve, rehabilitimi i ujësjellësve për 11 fshatra, si dhe përgatitjet për fillimin e ndërtimit të objektit të shkollës në Berishë.

Drejtori për shëndetësi, Hajdin Berisha, tha se situata epidemiologjike me EHKK, është e qetë, ndërsa thumbimet nga rriqrat, janë zvogëluar në masë të madhe dhe rastet e thumbimeve janë të pakta.

Ndërsa drejtori për bujqësi, Haxhi Krasniqi, njoftoi se ka përfunduar fushata e korrje-shirjeve në Komunën e Malishevës, ndërsa rendimentet janë më të mirat se vitin e kaluar, Krasniqi, tha se brenda pak ditësh, dot ë dalin me të dhëna të kompletuara nga shtabi komunal për fushatën e korrje shirjeve.

Edhe drejtorët e drejtorive tjera, kanë raportuar për aktivitete e tyre, ndërsa u bë e ditur se të gjitha shërbimet komunale në raport me qytetarët, po kryhen në rregull dhe pa probleme, si dhe për shkak të efikasitetit të zyrtarëve komunal, nuk ka pritje për kryerjen e shërbimeve, apo nxjerrjen e dokumenteve, edhe pse fluksi i qytetarëve, në këtë periudhë është mjaft i madh.



Të gjitha rrugicat e Bardhit do të shtrohen me kubëza

Malishevë, 27 korrik

Ka filluar implementimi edhe i një projekti me rëndësi për banorët e fshatit Bradh, ku do të rregullohen të gjitha rrugët e këtij fshati dhe do të shtrohen me kubëza. Me realizimin e këtij projekti, fshati Bardh, përveç rrugëve kryesore të cilat janë të asfaltuara, të gjitha rrugicat e fshatit do të jenë të rregulluara dhe lehtë të qasshme. Punimet në këtë fshat i ka inspektuar drejtori i urbanizimit, i cili ka kërkuar nga punëkryesi, cilësi në rregullimin e këtyre rrugëve.

“Fshatrat e thella, siç është edhe fshati Bardh, janë vendbanime me prioritet të veçantë, për shkak të ashpërsisë së reliefit dhe pozitës gjeografike që kanë, prandaj rregullimi i rrugëve do të përmirësoj jo vetëm lëvizjen brenda fshatit, por po krijohen kushte më të mira për jetuar dhe qëndruar në fshat”, tha drejtori i urbanizimit Ahmet Morina, i cili i uroi banorët për këtë projekt.

Nga ana tjetër drejtori Morina, gjatë inspektimit, edhe pse vetëm fillimi i punimeve në këto rrugë, kërkoi cilësi në implementimin e projektit, si dhe kërkoi bashkëpunim me banorët, në mënyrë që shtrimi i rrugëve me kubëza, të jetë i punuar mirë dhe në shërbim të plotë për lëvizjen e banorëve.

Përndryshe, sipas drejtorit Morina, në këtë fshat, do të shtrohen 1200 metra rrugë me kubëza, përderisa rrugët kryesore janë të asfaltuara.

MKRS dhe Komuna, nënshkruajnë marrëveshje për rregullimin e stadiumit

Malishevë, 27 korrik



Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komuna e Malishevës, sot kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për mbështetje financiare në renovimin dhe funksionalizimin e stadiumit të futbollit në qytetin e Malishevës. Kjo marrëveshje është nënshkruar



nga Ministri i MKRS-së, z.Shala dhe Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Begaj. Ky memorandum parasheh mbështetjen financiare për “Renovimin e Stadiumit të futbollit në Malishevë”, në vlerë prej 400 mijë euro.

Në bazë të Memorandumit, MKRS-ja investon mjete financiare prej 310 mijë eurosh, për vitin 2016 dhe 2017, ndërsa Komuna e Malishevës, merr përsipër të investojë mjetet në vlerë prej 90 mijë eurosh, në këtë periudhë dyvjeçare. Ministri Shala u shpreh se memorandumit që është nënshkruar sot mundëson realizimin një investimi kapital të një rëndësie të veçantë sepse krijon një hapësirë cilësore dhe të standardizuar për futbollistët e Malishevës. Renovimi i stadiumit është një parakusht për ta, në zhvillimin e garave dhe në përmirësimin e cilësisë së futbollit në këtë komunë, investimet në komunën e Malishevës nuk përfundojnë me kaq, tha Shala.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e falënderoi ministrin Shala për bashkëpunimin e ngushtë dhe ndihmën që ofron për Komunën e Malishevës. Ky projekt kapital për Malishevën është jashtëzakonisht i nevojshëm dhe i mirëpritur, sidomos për futbollistët, sepse ata do të kenë një vend ku do të garojnë dhe zhvillohen më tutje në sportin e futbollit tha Begaj.

Klubet e notit “Besa” dhe “Zenit” fitues të garës memoriale “Esmir Shala”

Malishevë, 28 korrik

Sot në pishinat e Banjës së Malishevës, organizuar nga KN “Besa”, Federata e Notit e Kosovës dhe Komuna e Malishevës, është mbajtur gara memoriale në not “Esmir Shala”, edicioni i dytë, ndërsa këtë garë e fituan klubet e notit “Besa”-Banjë, meshkujt dhe “Zenit”- Prishtinë, femrat. Në këtë garë, morën pjesë mbi 200 notues nga dhjetë klube të notit nga Kosova, pastaj veteran të notit dhe një garues nga Banja, që është notar në Austri.



Garën e ka hapur i pari i Malishevës, Ragip Begaj, i cili i falënderoi të gjithë për angazhimin e tyre, në organizimin e kësaj gare. “Malisheva nuk i harron asnjëherë sportistët e saj, të cilët kanë lënë gjurmë në sport, e sidomos në not, siç është Esmir Shala, ish reprezentues i Kosovës në not, ndërsa për mua është nderë i madh që sot e shpalli të hapur garën dhe juve të gjithë pjesëmarrës në garë, ju uroj suksese”, tha kryetari Begaj.

Në këtë garë ku morën pjesë një numër i madh i garuesve, në të gjitha disiplinat, në të gjitha kategoritë për meshkuj dhe femra, ishin shumë interesante. Garë e fortë është zhvilluar në çdo disiplinë, ndërsa më interesante ishin garat e stafetave dhe garat për veteran. Në konkurrencën e veteranëve, ju bë një prezantim i veçantë veteranit të notit, nëntë herë kampionit të Kosovës në not, Blerim Shala, i cili, siç u tha nga prezantuesi i Federatës së Notit të Kosovës, do ta përfaqësojë Kosovën në Kampionatin Botëror 2017, në Hungari, në kategorinë e veteranëve, në stilin bretkosë. Po ashtu, shumë interesante dhe atraktive, ishte edhe pjesëmarrja në këtë garë e notuesit Florian Shurdhaj, i cili garon në Austri dhe është i pozicionuar në vendin e katërt në këtë vend, në bazë të rezultateve të përgjithshme.

Në këtë garë memoriale, e cila është zyrtare në kalendarin e garave të Federatës së Notit të Kosovës, konkurrenca është ekipore, ku në bazë të rezultateve të përgjithshme, tek meshkujt, vendin e parë e zuri KN “Besa”-Banjë me 338 pikë, vendin e dytë e zuri KN “Termopan” me 101 pikë dhe vendin e tretë KN “Orllani” me gjithsejtë 96 pikë të grumbulluara në të gjitha garat.



Kurse në konkurrencën e femrave, vendin e parë e zuri KN “Zenit” me gjithsejtë 115 pikë të grumbulluara, të dytin KN “Prishtina” me 99 pikë dhe të tretin KN “Mitrovica” me 38 pikë.

Për veteran, në krol, vendin e parë e zuri Ilir Gllareva, të dytin Fazli Shurdhaj dhe të tretin Nuhi Buzhala, ndërsa në stilin bretkosë, vendin e parë e zuri nëntë herë kampioni i Kosovës, Blerim Shala.

Në fund ju kanë ndarë medalje, të gjithë notarëve fitues në secilin kategori dhe në secilën disiplinë, ndërsa ekipet në konkurrencën e përgjithshme, ju dhanë kupa, dhe garat i ka përmbyllur drejtoresha për kulturë, rini dhe sport në Malishevë, Blerta Krasniqi, e cila i falënderoi të gjithë për pjesëmarrje dhe për organizimin e kësaj gare.

Filloi renovimi i ankesit të shkollës së Mirushës

Malishevë, 29 korrik



Në fshatin Mirushë, kanë filluar punimet në renovimin e objektit të shkollës së fshatit, përkatësisht ankesit të shkollës. Ky aneks ishte dëmtuar në fillim të këtij viti, si pasojë e erërave të fuqishme. Renovimi i këtij aneksi, do të bëhet i tërësishëm dhe me një shtator, planifikohet që të dy objektet e shkollës, të hyjnë në funksion dhe nxënësit të mësojnë në një ndërrim.

Punimet në këtë shkollë, sot i kanë parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i arsimit Avdi Morina dhe drejtori i urbanizimit Ahmet Morina.

Drejtori i urbanizimit, Ahmet Morina, tha se “përveç kulmit, i cili është dëmtuar nga erërat, ky aneks do të rregullohet në tërësi dhe do ti plotësoj nevojat e shkollës së fshatit, ndërsa projekti për renovim ka një shumë prej 24 mijë euro”.

Drejtori i arsimit Avdi Morina, bëri të ditur, se me rregullimin e këtij aneksi, synohet që nxënësit të mësojnë në një ndërrim, pasi krijohet hapësirë e mjaftueshme për të gjitha klasat.



27 shkolla të Malishevës marrin donacion nga USAID-i

Malishevë, 29 korrik



Në kuadër të programit të USAID-it, për arsim, 27 shkolla të ciklit fillorë, kanë përfituruar një donacion nga USAID, në mjete konkretizuese, për klasat e para dhe të dyta. Ky donacion është shpërndarë sot, ndërsa në dhënien e donacioneve, mori pjesë edhe drejtori i arsimit Avdi Morina, i cili e falënderoi USAID-in për këtë donacion në mjete konkretizuese.

Këto donacione në mjete konkretizuese, janë dhënë për 27 shkolla, të cilat kanë qenë pjesë e trajnimeve nga USAID-i, ndërsa vlera e përgjithshme e donacionit është 6351.20 euro për të gjitha shkollat. Donacioni, apo paket që ju janë shpërndarë shkollave, brenda kanë mjete konkretizuese për klasat e para dhe të dyta, që do t'iu shërbejnë për mësimdhënie dhe mësimnxënie, në lëndët e gjuhës shqipe dhe të matematikës.

Ky donacion, është në kuadër të bashkëpunimit mes drejtorisë komunale për arsim dhe USAID-it, përkatësisht të Basic Education Program (BEP), e që ka për qëllim përmirësimin e kapacitetit të shkollave dhe përmirësimi i cilësisë në arsimin kosovar.